



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Data/Date:	04.06.2024
Nga/Od/From	Grupi punues
Për/Za/To:	Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit
CC	Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit
Tema/Subjekat/Subject	Raporti (me komente) për ecurinë e konsultimit dhe hartimit të Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna me theks neni 30-Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

-Me **17.11.2023**, kryetari i Komunës, Shaqir Totaj ka formuar grupin punues për hartimin e Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029, anëtarët e këtij grupi janë: Kujtim Shala, kryesues; Lirije Bytyqi, anëtare; Çelë Lamaj, anëtarë; Sulltan Badalli, anëtarë; Ramize Shala, anëtare; Bexhat Bytyqi, anëtarë; Nderim Bytyqi-OJQ AZHR, anëtarë.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **03.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Projekt-Strategjine-per-Zhvillim-Ekonomik-Lokal-per-Komunen-e-Prizrenit-2024-2029-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/iSeyFpsalToyN5NV/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42379>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-strategjine-per-zhvillim-ekonomik-lokal-per-komunen-e-prizrenit-2024-2029/>

Me 03.05.2024, njoftimi dhe strategjia përmes emailit u është dërguar: Qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata, drejtor të shkollave fillore dhe të mesme, bizneseve, organizatave studentore, ekspertëve të fushave të ndryshme, mediat lokale, shoqata të ndryshme, organizata rinore si dhe anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Me 14.05.2024, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/u-mbajt-konsultim-publik-me-qytetare-per-projekt-strategjine-per-zhvillim-ekonomik-lokal-per-komunen-e-prizrenit-2024-2029/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/PkzXrop7fCvuKKom/?mibextid=oFDknk>

Projekt-Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029 (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

28.05.2024, është publikuar procesverbali për mbajtjen e konsultimit publik, procesverbali është i publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Procesverbali-nga-mbajtja-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Projekt-Strategjine-per-Zhvillim-Ekonomik-Lokal-per-Komunen-e-Prizrenit-2024-2029-PDF-SCAN.pdf>

Dokumenti ka qenë në konsultim publik në uebfaqen zyrtare të komunës dhe platformën e konsultime publike, nga data **03.05.2024** deri me **20.05.2024**, ndërsa komentet janë pranuar deri me datë **20.05.2024**.

Përmes formës elektronike nuk janë pranuar asnjë komente, nuk është pranuar asnjë koment në formë fizike, kurse gjatë konsultimit janë pranuar 26 komente.

Tabelori me të dhëna të shkurtra:

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Numri i kërkesave të pranuar
1-Takime i drejtpërdrejtë me qytetarë për Projekt-Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029	14.05.2024 Nga-10:15 Deri-12:00	F 08 M 12 T 20	9	26 3-Pjesërisht 19-Refuzohen 4-Pranuara

Nr	Kërkesat /Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë/ sugjerim	Statusi i kërkesës /sugjerimi i pranuar pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
1	1-Nuk janë paraparë shkollat profesionale, të sigurohen transporte.	Afrim Tejeci	Refuzohet	Keto shkolla jane nen kompetence te MASHT-it
	2-Nxënësit që kryejnë shkollën profesionale të stimulohen me grande apo të sigurohet një hapsirë që të ushtrojnë profesionet e tyre në një afat të caktuar.		Refuzohet	Komuna ka parapare stimulim te te rinjeve me grante.
2	1-Terene spotive, hapsira të reja të shtigjeve, shtigje turistike në drejtim të Vrrinit dhe Nashecit.	Agon Ukallo	Refuzohet	Jane planifikuar nga DTZHE

	2-Shtegu malor Don Hill të rikthehet në gjendje si ka qen më herët.		Pranohet	Duhet te jete si projekt i ri i DTZHE-se
3	1-Komuna të krijoj parakushte për një qëndureshmëri në Biznese,duke marr parasysh lëvizjet demografike.	Arben Shala	Refuzohet	Jane parapare skema te granteve per mbeshtetje te bizneseve
	2-Dokumenti i Strategjisë të referohet edhe strategjive nacionale/ shembull: Stretegjia e rritjes së punueshmërisë në Kosovë-të jetë ne vi me politikat e shtetit.		Refuzohet	Ne dokument eshte referimi ne strategjithe kryesore nacionale
	3-Pjesa e arsimit në tërësi të fokusohet në arsim profesional jo në ndërtim të objekteve-shkollave.		Refuzohet	Kompetence e MASHT-it
	4-Në arsim dual, praktika, marrëveshje me biznese, prodhime, artizanale.-të shkathësohet rinia.		Refuzohet	Kompetence e MASHT-it
	5-Shëndetësia-shërbimet ambulatorë të funksionojnë edhe për turistë.		Refuzohet	Sherbimet jane te hapura edhe per turistet
	6-Infrastruktura- tek Turizmi-trashëgimi, ndërmarrjet e vogla e të mëdhaja për zhvillimin e bizneseve.		Refuzohet	Jane parapare skema te granteve per mbeshtetje te bizneseve
	7-Rregullimi I fasadave dhe dritareve nënkala.- do të ndikoj në interesimin e turistëve.		Pranohet	Te jete projekt i DTZHE-se
4	1-Strategjia nuk ka asnjë specifikim për gratë në biznes(mbeshtetje).	Tringa Kasëmi	Refuzohet	Ne skema te granteve eshte potencuar perparësia per grate.
	2-Eshte përmend ndërtim i Qps-ës së dytë por te Qpsja e pare nuk ka zyrtar- Qpsja duhet të futuet në strategji jo për ndërtim por për sfidat që I ka në tërësi.		Refuzohet	Nuk eshte ne kuader te prioritetëve te startegjisë
5	1-Përkujdesje për personat me aftësi të kufizuar- shembull një lloj të rehabilitimi si një bazen/noti.	Antigona Shestan	Pranohet	Sipas ligjeve, përkujdesja specifikohet për këta persona.

	2-Ankesë se nuk kanë marr pjesë të gjithë drejtorët e drejtorive si dhe në material nuk janë konkretizuar cestjet e qarta.		Refuzohet	Dokumenti është i qartë dhe i fokusuar në zhvillim lokal ekonomik.
	3-Mungesë e monitorimit dhe vlerisimit të këtyre objektivave dhe masave.		Refuzohet	Secila drejtori përkatëse është e mandatuar të monitorojë projektet e veta dhe të bëjë rishikime/adaptime të nevojshme.
6	1-Të bëhet monitorimi I turizmit në drejtim të trashigimis kulturore, mungojnë profesionistët të institucioneve mbrenda Qendrës historike.	Hasan Ahmetaj	Refuzohet	Eshtë cek rëndësia e trashëgimise historike.
7	1-Mungojnë shoqatat e turizmit malor, nuk janë cek kishat dhe muzet mirëmbajtja e tyre.	Veron Tara	Refuzohet	Eshtë cek rëndësia e trashëgimise historike.
	2-Nuk kemi mungesë të hapsirave të sportit por kemi mungesë të sallave kulturore për mbajtjen e aktiviteteve.		Refuzohet	Nuk është planifikuar nga Drejtoria e Kulturës
	3-Shtëpitë tradicionale të kthehen në hotele apo restorante.		Refuzohet	Kjo i takon sektorit privat
	4-Mungesë e ofertave turistike.		Refuzohet	Kjo i takon sektorit privat
	5-Mungesa e puntorive, artizanaleve, aftësim profesional.		Refuzohet	Kompetence e MASHT-it
	6-Nuk është përmendur "Plani I Menaxhimit" të qendrës historike të Prizrenit e cila nga ministria është implementuar 10% kurse nga Komuna 0%.		Pjesërisht	Me tepër është kompetence e ministrisë
8	1-Zyrja informative për turizëm të renovohet dhe të fillojnë puntorët të marrin pagesë (rrogë) sepse është viti I 8-të që punojnë vullnetarishtë.	Flaka Bamja	Pjesërisht	Do të vepohet sipas ligjeve që janë në fuqi.
	2-Të ndalohen guidat nga jashtë por edhe ata që i ka angazhu GideKS sepse nuk ka		Pjesërisht	Do të vepohet sipas ligjeve që janë në fuqi.

	asnjë njohuri bazike për trashigimi kulturore dhe pa anjë ditë përvojë.			
9	1-Të merren parasysh kerkesat te njerezve te remdom dhe jo gjithmone te fortit te perkrahen.	Medisa Sagdati Karavidaj	Pranohet	Komuna eshte e hapur per kerkesat e te gjithë qytetareve.

Shkurtesat:

F-Femra

M-Meshkuj

T-Totali

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

1. Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Projekt-Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Prizrenit 2024-2029,
2. Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,
3. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik,

Raporti është përgatitur nga :
